

Pandemia, turizmi dhe pasojat në bizneset sezonale

Është jorealiste të mendosh që pandemia Covid - 19 do të jetë thjesht kalimtar tranzit në vendet e Ballkanit. Duke patur parasysh se një pjesë e mirë e shteteve anëtare janë ekonomi të vogla, shumë prej tyre parësisht të varura nga turizmi, është e pritshme që goditja do të lërë gjurmë.

Në Shqipëri, sipas WTTC, sektori i turizmit dhe udhëtimeve kontribuon në rreth 25% të punësimit total dhe 27% të PBB. Ndërsa në Kroaci, Greqi, dhe Mal të zi të ardhurat nga turizmi kalojnë 20% të PBB.

Impakti në para - sezonin turistik, është tashmë evident, me anulime të shumë rezervime. Duke konsideruar edhe masat e fundit të marra nga qeveria shqiptare me mbylljen e kufijve dhe pezullimin e trafikut ajror me shumë tregje turistike në Europë, duket se situata mund të marrë nota më serioze.

Përveç ndikimit në anulime, të cilat në rastin më të mirë synohet të zhvendosen në sezonin e vjeshtës, goditja e sektorit të turizmit do të përcjellë goditje të tjera edhe në industritë furnizuese apo të lidhura me turizmin. Zinxhiri i ofertës në turizëm përbëhet edhe nga shumë sektorë të tjerë të ndërlidhur me të, si agroturizmi, agroindustria përpunuese, transporti, shërbimet shpërndarëse ushqimore etj.

Sipas European Manifesto Alliance, miliona vende pune janë në risk, dhe shumë SME në këtë sektor shoqërohen nga risku për mbyllje. Sipas WTTC, sektori i turizmit dhe udhëtimeve në nivel botëror është në risk për të shkurtuar rreth 50 mln vende pune dhe sipas vlerësimeve të WTTC mund të nevojiten më shumë se 10 muaj për rikuperimin e industrisë. Për më tepër, për shkak se bllokimi i aktivitetit turistik mund të vazhdojë me muaj të tërë, efektet e COVID - 19 në turizëm do të jenë akoma dhe më të qarta në vitin 2021.

Sipas UNWTO, hyrjet e turistëve në nivel botëror do të ulen nga 30% në 2019 në 20% në 2020.

Megjithatë, për të analizuar qartë efektet që do të ketë pandemia në turizëm duhet të analizojmë edhe mënyrën se si turizmi është i strukturuar brenda vendit. Të gjitha sfidat që do të shfaqen në menaxhimin e krizës nga pandemia mund të qartësojnë krijimin e një plani të qëndrueshëm për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit. Patjetër që vëmendja në masat higjienosanitare do të jetë më e madhe. Në rastin e Shqipërisë një nga sfidat e sektorit të turizmit ka qenë dhe zgjatja e sezonit turistik, element i cili duhet me të patjetër të stimulohet këtë vit.

Në nivel botëror është rezultuar se sektori i turizmit pavarësisht krizave ekonomike, fatkeqësive natyrore është ripërtërirë relativisht shpejt. Lind pyetja, po në rastin e Shqipërisë, sa elastike është oferta dhe kërkesa për produkte turistike, si pasojë e një shoku të tillë?

Rikuperimi i turizmit duhet bërë në bashkëpunim me sektorin privat. Të dy aktorët e tregut duhet të gjejnë mënyra si të përdorin burimet në mënyrën më efektive të mundshme. Suporti për turizmin duhet të jetë prioritet i paketave suportuese në përgjigje të krizës, shoqëruar me plan rikuperimi dhe plan veprimi:

-Ndihmë shtetërore për sektorin e turizmit dhe udhëtimeve

-Akses i shpejtë dhe i lehtë ndaj huave afatshkurtra dhe afatmesme, për të kompensuar humbjet aktuale

-Më shumë suport për pjesëmarrje ndaj projekteve me fokus rikuperimin ndaj Covid - 19

-Skema afatshkurtra për të mbështetur punonjësit e këtij sektori si dhe programe ritrajnuese, por edhe suport për të vetpunësuarit në këta sektorë

-Paketa fiskale lehtësuese për sipërmarrjet e të gjitha llojeve dhe përmasave, kryesisht SME

-Fushata ndërgjegjësuuese për mos anulimin e plotë të prenotimeve por shtyrje të tyre për më vonë. Si pasojë e krizës pjesa më e madhe e prenotimeve anulohen dhe vetëm një pjesë e tyre shtyhen për muajt më vonë

-Përpjekje për zgjatjen e sezonit turistik

-Mosdërprerja e investimeve në sektorin e turizmit, si nga sipërmarrjet e vogla kryesisht para sezonit, por edhe ato të mëdha

-Ulje e taksave të udhëtimit, suportim destinacionesh duke rritur buxhetin për promovim dhe marketing, por duke dhënë edhe informacion në termat e këshillimeve nga autoritetet vendore për rajonet e prekura dhe masat e marra.

Turizmi është një industri mjaft e ndikuar nga një sërë goditjesh, të cilat është e vështirë të kontrollohen, dhe për më tepër në momentin që do të nisë aktivizimi i jetës për bizneset, sektorit të turizmit i duhet akoma dhe më shumë kohë të përshtatet për rinisje.

Industria do të rikuperohet por kjo do të dojë kohën e saj. Vetëm kur konsumatorët të perceptojnë që është e sigurt të lëvizësh mund të ketë kthesë.

Në këto kushte, turizmi brenda vendit do të jetë i pari që do të reagojë! Sigurisht, sezoni i këtij viti nuk do të jetë një sezon normal por le të shpresojmë që të paktën një pjesë e tij do të shpëtojë!

Deri atëherë, "Stay Safe"!

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



"Bizneset e Greqisë në kohën e COVID-19"

Nga Arjan Gusho, Kryetari i "Lidhjes së biznesmenëve greko-shqiptarë në Greqinë e Veriut"

Është e vërtetë që COVID-19 ka alarmuar gjithë botën, edhe shtetet më të forta. Kjo pandemi do shkruhet në historinë moderne si një plagë për njëzimin, sepse numri i të infektuarve ka kaluar mbi 1 milion, kurse vdekjet kanë arritur mbi 80.000. Por çfarë do të shkruaj historia për anën ekonomike? Do të jetë një faqe e zezë për historinë e ekonomisë apo do të transformohet në një "Success Story"?

Greqia është një nga shtetet që reagoi shumë shpejt dhe mori gradualisht masa, jo vetëm për të kufizuar ritmin e përhapjes në masë të virusit, por dhe për të stabilizuar situatën në ekonominë reale. Në datën 28.02.2020 filluan efektet e para, u anuluan karnavalet dhe festat fetare. Gradualisht u mbyllën shkollat, kinematë, qendrat tregtare, gjykatat. Në datën 16.03.2020, shteti deklaroi karantinën e përgjithshme, e cila vazhdon edhe sot.

Për ekonominë, shteti aplikoi një marrëveshje me institucionet e Bashkimit Europian dhe garantoj fondet të larta. Për punonjësit që pezulluan bizneset me vendim qeverie do jepet 800€ si shpërblim dhe do kenë lehtësime për pagesën e qirasë. Gjithashtu, për biznesmenët ofrohen masa shpërblimi 600 deri në 800 euro, uljen e siguracioneve dhe taksave (-25%) n.q.s ato paguhen në kohën e duhur, si dhe lehtësime të tjera për qytetarët të cilët kanë kredi bankare. Tatimi për produktet higjienike, p.sh dorashka, maska, alkool etj., u ul nga 24% në 6%.



Masat në sektorin e shëndetit duken se funksionojnë mirë, sepse ritmi i përhapjes së COVID_19 është në ulje. Në fushën e ekonomisë për bizneset shqiptare që ushtrojnë aktivitet në Greqinë e Veriut, situata është rënduar dhe ka pësuar një rënie të dukshme që shkon nga 20% deri në 80% sipas profesioneve dhe bizneseve të ndryshme, si dhe një rritje të ndjeshme të papunësisë. Ky pushim i menjëhershëm dhe i paparashikuar i ekonomisë si dhe masat që mori qeveria për kufizimin e virusit COVID-19, drejtuan në një rënie të dukshme të zhvillimit ekonomik me


probabilitet të madh për falimentim deri në 10% të bizneseve që funksionojnë aktualisht. Është e dukshme që këto masa ndihmuese janë pozitive, por jo të mjaftueshme për të përballuar nevojat e bizneseve që aktualisht vështirësohen.

Në këtë situatë, "Lidhja e biznesmenëve greko-shqiptarë e Greqisë së Veriut" kërkon nga qeveria qëndrore dhe lokale të vihen në lëvizje dhe të gjejnë metoda efektive për të ndihmuar këto biznese të ndikuara negativisht nga kriza që të anashkalojnë vështirësitë ekonomike dhe të kapin ritmin normal të zhvillimit. Sido që të jetë situata, kemi bindjen se ajo do të kalohet qoftë dhe me dhimbje. Për momentin ka rëndësi të jemi të shëndetshëm dhe të gatshëm për të rifilluar aktivitetet tona ekonomike me ide dhe praktika të reja. Jemi optimistë!



Remitancat mund të ulen në nivelin e krizës ekonomike të vitit 2009

[> Link <](#)



Si po ndërhyjnë Bankat Qendrore në botë për të mbështetur ekonomitë e tyre? [>Link <](#)

Java ne lajme



Duhet optimizëm dhe shpresë e jo frikë e psikozë terrori e luftë!

[> Link <](#)



Masat ekonomike, krahasim me Europën/ Instituti i Vienës për Studime Ndërkombëtare: Paketa sa 1.2% e PBB-së, norma e dytë më e lartë në rajon [> Link <](#)

Vendime



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin Nr. 277, datë 06.04.2020 "Për miratimin e garancisë shtetërore të huasë me bankat e nivelit të dytë për pagat e bizneseve, aktiviteti i të cilëve është prekur nga vendimet e qeverisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, si edhe për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit".

Miratimin e linjës së garancisë shtetërore, në vlerën 11 000 000 000 (njëmbëdhjetë miliardë) lekë, në favor të bankave të nivelit të dytë, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, pjesë e skemës së garancisë që do të mundësojë huadhënien për të përballuar pagat e tregtarëve ose të shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është mbyllur ose është ndikuar me ulje të xhiros, si pasojë e vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhrave të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-9.

Vendimi prezanton kushtet dhe kriteret për marrëveshjen e garancisë shtetërore të huasë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit për bizneset që do të marrin kredi, dhe autorizimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të lidhur marrëveshje me bankat.

Mund të lexoni vendimin e plotë: [këtu](#)

Kursi zyrtar i këmbimit



Dollar Amerikan	USD	116.37	+0.01	↑
Euro	EUR	126.53	+0.17	↑
Poundi Britanik	GBP	144.38	+1.09	↑
Franga Zvicerane	CHF	119.93	+0.18	↑
Jeni Japonez (100)	JPY	106.84	-0.09	↓
Dollari Australian	AUD	72.57	+1.09	↑
Dollari Kanadez	CAD	82.94	+0.02	↑

Rreth Dhomës së Biznesit për Diasporën Shqiptare

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare është organizata e parë në shërbim të bizneseve të Diasporës. Si një organizatë e pavarur jo-fitimprurëse, ne jemi të përkushtuar të ndihmojmë dhe të nxisim bizneset e të gjitha madhësive për të maksimizuar potencialin e tyre në Shqipëri. Dhoma e Biznesit të Diasporës është një mundësi reale për mbështetjen e investitorëve të Diasporës që dëshirojnë të krijojnë apo të zgjerojnë biznese të tyre në atdhe.



Official partner website:

www.monitor.al



Official partner website:

<http://www.yellowpagesalbania.com>

